



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**VENDIM  
Nr.255, datë 09.05.2024**

**MBI  
REFUZIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARIT {...} “PËR PËRJASHTIMIN E  
RELATORES ZNJ. {...} NGA PROCEDURA E VLERËSIMIT ETIK DHE  
PROFESIONAL, PËR PERIUDHËN 2017-2019”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.05.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Mbi pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit {...} “Për përjashtimin e relatores znj. {...} nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit {...}, regjistruar me aktin nr. 1461 prot., datë 05.03.2024, në të cilën kërkon përjashtimin e anëtares relatores znj. {...} nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017-2019 të tij,

**V Ë R E N**

**I. RRETHANAT E FAKTIT**

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është administruar kërkesa nr. 118 prot., datë 05.03.2024<sup>1</sup> e gjyqtarit {...} pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet të cilës kërkon përjashtimin e relatores znj. {...} nga procedura e vlerësimit të tij etik dhe profesional për periudhën 2017-2019. Kërkesën për përjashtim, z. {...} e ka paraqitur duke marrë shkas nga vlerësimi etik dhe profesional që i është bërë nga Këshilli për vitin 2022, në të cilën ka qenë në cilësinë e relatores përsëri znj. {...}.

2. Konkretisht, gjyqtari parashtron në kërkesën e tij se me email-in e datës 14.09.2022, është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit: Relatore znj. {...} dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. {...}. Z. {...} ka

<sup>1</sup> Protokolluar në KLGJ me aktin nr. 1461 prot., datë 05.03.2024

konfirmuar marrjen dijani, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit dhe nuk ka kërkesë për përjashtimin e tyre. Kjo procedurë vlerësimi është akoma në proces dhe nuk ka përfunduar.

**3.** Pas këtij momenti, me email-in e datës 15.06.2023, ndaj gjyqtarit ka filluar procedura e detyruar e përshpejtuar e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2022. Nëpërmjet procedurës së shortit janë përzgjedhur vlerësuesit: Relatore znj. {...}, dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. {...}. Për të cilat z. {...} ka shprehur dakordësinë e tij.

**4.** Gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit për vitin 2022, me email-in e datës 17.01.2024, gjyqtarit i janë komunikuar projektaktet përkatëse për vlerësimin e tij për vitin 2022. Gjithashtu, i është bërë me dije e drejta për të aksesuar dosjen e vlerësimit dhe për ta kundërshtuar atë me shkrim brenda 2 javëve nga data e marrjes së njoftimit. Me email-in e datës 22.01.2024, ka konfirmuar marrjen e njoftimit, si dhe ka bërë me dije se e ka të nevojshme aksesimin e dosjes së vlerësimit dhe në vijim të paraqes kundërshtime dhe prova të reja. Gjithashtu, ka kërkuar të degjohet gjatë seancës dëgjimore në KLGJ. Me tej gjyqtari shprehet se, pavarësisht se ka kërkuar të aksesojë dosjen e vlerësimit, nga ana e relatores nuk i është kthyer përgjigje. Kjo gjë e ka detyruar që në respektim të afatit të caktuar, të paraqes kundërshtimet e tij, së bashku me provat shkresore.

**5.** Kërkesën për përjashtimin e relatores {...} nga procedura e vlerësimit për periudhën 2017-2019, z. {...} e bazon kryesisht në këto pretendime:

- i. Mosdhënia e aksesit në dosjen e vlerësimit sipas kërkesës së tij. Gjyqtari bën me dije se nëse do të kishte patur mundësi aksesimi të dosjes edhe kundërshtimet e tij do të ishin më të plotë, duke paraqitur një tablo më të qartë të situatës dhe me një pritshmëri ndryshe vlerësimi në përfundim të këtij procesi. Ky moment për z. {...} vë në dyshim paanësinë e relatores znj. {...}.
- ii. Momenti tjetër në të cilën z. {...} vë në dyshim paanësinë e relatores është gjatë prezantimit të projekt-vlerësimit të tij për periudhën 2022. Ai pretendon se relatorja për treguesin 4.C.a “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, nuk mori në konsideratë provën shkresore nr. 91/1 prot., datë 23.01.2024 të Shkollës së Magjistraturës të depozituar prej tij, dhe si rrjedhojë nuk u ndryshua pikëzimi për këtë tregues.
- iii. Ndërsa, momenti tjetër i referohet kur ka dëgjuar regjistrimin audio të seancës për vlerësimin e tij, për vitin 2022. Ai shprehet se nga dëgjimi i këtij regjistrimi kuptohet tendenca e relatores për të mos pranuar shkresën zyrtare të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohë që ajo referuar dispozitave ligjore në fuqi përbën akt me fuqi të plotë provuese. Kjo gjë sipas z. {...} ka penguar edhe Këshillin për të vlerësuar edhe treguesit e tjerë të vlerësimit, për të cilat ai kishte paraqitur kundërshtimet përkatëse.

**6.** Sa më sipër, z. {...} shprehet se shkaku i përjashtimit të relatores, znj. {...} nga procedura e vlerësimit të tij për periudhën 2017-2019 ka lindur në datë 04.03.2024, në të cilën ai ka

dëgjuar regjistrimin audio të seancës plenare të Këshillit. Për këtë arsye, kërkesën për përjashtimin e saj po e paraqet në këtë moment procedural.

7. Kërkesa për përjashtim i është komunikuar edhe relatores së çështjes, znj. {...}, e cila me shkresën nr. 1461/1 prot., datë 19.04.2024 ka shprehur qëndrimin se nuk ka shkaqe për përjashtimin e saj nga procedura e vlerësimit të gjyqtarit për periudhën 2017-2019.

8. Nga ana tjetër, gjyqtari {...} e ka kundërshtuar edhe gjyqësisht raportin e tij të vlerësimit për vitin 2022. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 34, datë 16.04.2024 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë padie.

## II. VLERËSIMI I KËSHILLIT

9. Neni 75 pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar parashikon rastet në të cilat një anëtar i Këshillit duhet të heqë dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin ose komandimin e një gjyqtari dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një gjyqtari, si dhe nga çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një gjyqtari ose të funksionarëve të tjerë të sistemit gjyqësor<sup>2</sup>. Ndërsa, neni 76 pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar ka përcaktuar shprehimisht se gjyqtari mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative **vetëm në fazën paraprake të procesit**, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75, të këtij ligji.

10. Më tej, në bazë të nenit 10 të Vendimit të KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019, “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në shkronjën a) të tij përcaktohet se **veprimet paraprake** përfshijnë hartimin, miratimin dhe publikimin e programit vjetor të vlerësimeve, **caktimin e relatorit** dhe të nëpunësit përgjegjës për çdo vlerësim. Në këtë kuptim, në bazë të neneve 85, pika 2 dhe 89, pika 3 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të Vendimit të KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019, “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, gjyqtari njoftohet për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të cilitdo anëtar të

---

<sup>2</sup> Konkretisht, rastet e heqjes dorë të anëtarit të Këshillit janë: a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën; b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij; c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet; ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor; d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit /bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor.

Këshillit. Pra, mundësia për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo nëpunësit përgjegjës i jepet gjyqtarit subjekt vlerësimi etik e profesional në fazën paraprake të procesit të vlerësimit etik e profesional.

**11.** Në rastin konkret, nuk jemi në fazën paraprake të procesit të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017-2019 të gjyqtarit {...}. Kjo fazë ka kaluar duke qenë se që më datë 14.09.2022, z.{...} është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit. Me email-in e datës 20.09.2022, z.{...}, ka konfirmuar marrjen dijani, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit dhe se nuk ka kërkesë për përjashtimin e tyre. Pra, faza paraprake e kësaj procedure vlerësimi ka përfunduar dhe është në proces të hartimit të projektraportit të vlerësimit. Sa më sipër, vlerësojmë se në referim të dispozitës së përmendur më sipër, duke qenë se nuk jemi në fazën paraprake të vlerësimit, gjyqtari nuk legjitimohet proceduralisht për të paraqitur kërkesën për përjashtimin e relatores {...}.

**12.** Në lidhje me themelin e kërkesës për përjashtimin e relatores {...}, vlerësojmë se në rastin konkret nuk jemi përpara zbatimit të nenit 75 të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, pasi nuk plotësohet asnjëri nga rastet e heqjes dorë të anëtarit të Këshillit që parashikon kjo dispozitë. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon se anëtari i KLGJ-së është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një gjyqtari, në rastet e mëposhtme:

- a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;*
- b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij;*
- c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet;*
- ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor;*
- d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit/bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor.*

**12.1** Në lidhje me shkaqet e parashtruara për përjashtimin e relatores {...}, së pari z.{...} pretendon se atij nuk i është dhënë mundësia të ketë akses në dosjen e vlerësimit. Ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi e gjithë procedura për vlerësimin e gjyqtarit për periudhën 2022 është kryer konform neneve 68, 69 e në vijim, të ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, si dhe rregullave të përcaktuara në vendimin nr.263. datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu, pas hartimit

të projektraportit të vlerësimit konform nenit 94 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, dhe nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 263, datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në rrugë elektronike, gjyqtarit i është njoftuar projektraporti i vlerësimit, së bashku me shtojcën e tij (tabelën e pikëzimit) të hartuara nga relatorja, si dhe raporti analitik i hartuar nga nëpunësja përgjegjëse duke i bërë me dije mbi të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit dhe të drejtën për të paraqitur kundërshtime dhe provat përkatëse që mund të vlerësonte të arsyeshme, si dhe me të drejtën për tu dëgjuar në seancë dëgjimore përpara Këshillit. Gjyqtari nëpërmjet e-mail-it të datës 22.01.2024, ka konfirmuar marrjen dijeni për projektraportin e vlerësimit duke parashtruar se do të paraqiste kundërshtime lidhur me projektraportin dhe se kishte nevojë të aksesonte dosjen e vlerësimit. Por pavarësisht kësaj, vetë gjyqtari nuk e ushtroi të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit, duke paraqitur kundërshtimet e tij me shkrim si dhe provën ku mbështeste kundërshtime e tij, të cilat ju vunë menjëherë në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe u morën në shqyrtim në tërësi në seancë plenare. Këshilli e ka të pamundur të vërë në dispozicion kopjen e plotë të dokumentacionit të dosjes së vlerësimit, dhe për këtë arsye e njofton si gjyqtarin subjekt vlerësimi por edhe anëtarët e saj për të aksesuar dosjen e vlerësimit fizikisht, subjekte të cilët kur e kanë vlerësuar të arsyeshëm kanë aksesuar dosjen e plotë të vlerësimit. Në këto rrethana, gjyqtari ka qenë i lirë të paraqitej pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor e të aksesonte në çdo moment dokumentacionin përbërës të dosjes së tij të vlerësimit.

**12.2** Sa më sipër, ky pretendim i gjyqtarit është tërësisht i pabazuar, në kushtet kur në asnjë moment nuk i është mohuar e drejta për të aksesuar dosjen e vlerësimit.

**13.** Për sa i përket pretendimeve se në rastin konkret vihet në dyshim paaanësia e relatores {...} për shkak se edhe pasi z. {...} ka depozituar provën shkresore, Vërtetimin nr.9/1 prot., datë 23.01.2024 të Shkollës së Magjistraturës, ajo ju ka qëndruar gjetjeve të bëra në projektaktin e raportit pa ndryshuar pikëzimin, vlerësojmë se edhe ato nuk qëndrojnë. Vërtetimin nr.9/1 prot., datë 23.01.2024 i Shkollës së Magjistraturës, është paraqitur si provë pas hartimit të projektraportit të vlerësimit të gjyqtarit, projektraport i cili së bashku me kundërshtimet dhe provat e reja të paraqitura i janë njoftuar rregullisht anëtarëve të Këshillit dhe vlerësohen vetëm nga Këshilli në seancë plenare. Projektraport i vlerësimit, përmban vetëm aktet dhe të dhënat e parashikuara në ligj, të cilët janë pjesë e dosjes së vlerësimit, të administruara përpara datës së vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale “Për plotësinë e procedurës dhe dokumentacionit të dosjes së vlerësimit për gjyqtarin”, vendim që në rastin konkret është marrë në datë 09.01.2024.

**13.1** Në nenin 93 pika 5 dhe 6 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, parashikohet se:

*“...5. Projektraporti i vlerësimit përmban:*

*a) të dhënat personale të magjistratit: arsimimi, vjetërsia, nivelet e mëparshme të vlerësimit, si dhe informacion të përgjithshëm për periudhën në të cilën bëhet vlerësimi, dhomën ose*

*seksionin pranë së cilës ka ushtruar funksionin dhe për masat disiplinore që janë dhënë ndaj magistratit në periudhën në të cilën bëhet vlerësimi;*

*b) të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit dhe analiza e tyre për vlerësimin e veprimtarisë së magistratit, sipas kriterëve të vlerësimit;*

*c) propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit;*

*ç) propozimin për trajnime ose rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar veprimtarinë e magistratit.*

*6. Projektraporti i vlerësimit shoqërohet me raportin që përshkruan dhe analizon në mënyrë të detajuar të dhënat e mbledhura.*

Në rastin konkret, projektraporti i vlerësimit është i plotë, përmbush të gjitha kriteret ligjore, si dhe është hartuar edhe në përputhje me “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, të miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e si i tillë është vlerësuar edhe nga Këshilli me vendimin nr. 72 datë 20.02.2024 “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022”.

**13.2** Po ashtu në përputhje me nenin 94 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se:

*“1. Magjistrati njoftohet për projektraportin e vlerësimit, si dhe informohet për të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit.*

*2. Magjistrati ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim projektraportin e vlerësimit brenda dy javëve nga data e marrjes së njoftimit. Magjistrati mund të paraqesë prova të reja, me përjashtim të vendimeve gjyqësore dhe akteve të hartuara prej prokurorit.*

*3. Magjistrati mund të kërkojë të dëgjohet gjatë seancës dëgjimore në Këshill. Përmbajtja e deklaratës me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore”,*

*Z.{...} e ushtroi të drejtën për të paraqitur kundërshtime dhe prova të reja, si dhe të drejtën për t’u dëgjuar. Në përputhje me nenin 95 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, të gjitha pretendimet he provat e paraqitura nga gjyqtari u morën në shqyrtim dhe u vlerësuan në tërësi nga Këshilli në mbledhjen e datës 20.02.2024. Në përfundim, Këshilli vendosi të miratojë projektraportin e vlerësimit me ndryshimet përkatëse në nivelin e vlerësimit dhe pikëzimit të gjyqtarit.*

**14.** Në lidhje me pretendimin se relatorja ka shfaqur tendencë për të mos marrë në shqyrtim provën e paraqitur, Vërtetimin nr.9/1 prot., datë 23.01.2024 të Shkollës së Magjistraturës, evidentojmë faktin se relatorja ashtu edhe çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të ngre diskutime të cilat i vlerëson të nevojshme në kuadër të një vendimmarrje të caktuar. Në rastin konkret, rezulton që pas diskutimeve të bëra në seancë plenare, relatorja ka bërë propozimet përkatëse që i ka vlerësuar të arsyeshme, një ndër të cilat ka qenë edhe ndryshimi i pikëzimit për treguesin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, gjë e cila solli edhe ndryshimin e nivelit të vlerësimit pasi u miratua nga Këshilli. Projektraporti i vlerësimit pasi u shqyrtua në

mbledhje plenare, u kthye në Raport vlerësimi, duke pasqyruar në të në mënyrë të përmbledhur kundërshtimet e gjyqtarit dhe ndryshimet përkatëse në arsyetim dhe pikëzim.

### **III. KONKLUSIONE**

**15.** Për sa është argumentuar më sipër, rezulton se procedura e vlerësimit etik dhe profesional e gjyqtarit {...} për periudhën e vlerësimit 2022 është zhvilluar në respektim të parimit të pavarësisë, meritokracisë, parimit të procesit të rregullt ligjor, si dhe të paanësisë. Në këto kushte, rezulton se nuk ka shkaqe ligjore për përjashtimin e relatores znj. {...} nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017-2019 të gjyqtarit z. {...}.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenet 72, 75 dhe 76 pika 2 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 85 dhe 89 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 12 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” të KLGJ-së,

#### **V E N D O S I :**

1. Refuzimin e kërkesës nr. 1461 prot., datë 05.03.2024 të gjyqtarit z. {...}, për përjashtimin e anëtares relatores znj. {...} nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} dhe anëtares së Këshillit znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

#### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**